




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr Prot. 03-02/4028/17
Dep. 02	Gr Prot. 11.12.2017
Nr. l. faq. 02	Prot No. 11.12.2017
Broj stranica	Data Datum 11.12.2017
Nr. pages	Date
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2468/17, për zyrtarin e lartë znj. Erna Hasangjekaj, Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në Ministrinë e Administratës Publike, për shkak se ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2468/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë znj. Erna Hasangjekaj, Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në Ministrinë e Administratës Publike.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë znj. Erna Hasangjekaj, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër N.SH. "Resurset Globale" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese znj. Hasangjekaj, ka ardhur në takim në zyrat e AKK-së dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar lidhur me rastin e iniciuar për të.

Gjatë këtij takimi znj. Erna Hasangjekaj, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qen i informuar se kjo situatë është në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe ka deklaruar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bëjë ndryshimet dhe do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj shkrese nga znj. Erna Hasangjekaj, Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në Ministrinë e Administratës Publike, kemi pranuar dokumentin e lëshuar nga ARBK-ja, ku shihet se znj. Hasangjekaj, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin me emër N.SH “Resurset Globale”.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga znj. Erna Hasangjekaj, Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike në Ministrinë e Administratës Publike, duke u larguar nga funksioni si person i autorizuar në biznesin privatë janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

